



Pranuar / Dorezuar Prijehena/Prodato Received/Delivered	25 - 11 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHUK	7425/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.907/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani -anëtarë dhe Avdyl Bektshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.907/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 24.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.907/2022 e datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, fizikisht më datë 13.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6147/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e tij si “Udhëheqës i Divizionit për Avansimin e të Drejtave të Njeriut” në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa me datën 21.10.2022 ankuesi ka parashtruar plotësim ankesën me numër të protokollit 6373/2022 duke i bashkangjitur edhe provat e tjera relevante.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6147/2022 të datës 13.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësim ankesën me numër të protokollit 6373/2022 e datës 21.10.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Akt emërimi me nr.prot.219 i datës 10.03.2014; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik për i datës 13.06.2000; Përgjigje në njoftim me numër të protokollit 1060 i datës 25.03.2022;

Certifikatë e lësuar nga "Focus & I School for Foreign Languages and Informatics Prishtina" për periudhën kohore 14.11.2020 deri me 18.12.2020; Certifikatë e lësuar nga "Focus & I School for Foreign Languages and Informatics Prishtina" për periudhën kohore 12.10.2020 deri 12.11.2020; Certifikatë e lësuar nga "Focus & I School for Foreign Languages and Informatics Prishtina" për periudhën kohore 11.09.2020 deri 12.10.2020; Certifikatë e lësuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ketnet i datës mars 2022; Certifikatë e lësuar nga Instituti i Kosovës për integrim Evro-Atlantike për periudhën kohore 7-18 janar 2022; Certifikatë e lësuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike e datës 19 dhe 25 shtator 2019; Certifikatë e lësuar nga Ministria e Administratës Publike e datës shtator 2017; Certifikatë e lësuar nga Universiteti i Sarajevës për me nr.01-07-399/17 e datës 31.01.2017; Letër rekomandimi për me nr.587/2005 e datës 12.09.2005; Letër rekomandimi e lësuar nga UNMIK e datës 27.07.2004; Vërtetim i lësuar nga Institucionet Vetqeverisëse të Kosovës/Zyra e Kryeministrit me nr.866 e datës 13.09.2004; Letër rekomandimi për e lësuar nga Institucionet Vetqeverisëse të Kosovës/Zyra e Presidentit të Kosovës e datës 24.05.2004; Formular i vlerësimit për nënpunësit e jashtëm për vitin 2021(deri në muajin gushtë); Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale i datës 29.01.2021; Formular i vlerësimit e rezultateve në punë për periudhën shtator-dhjetor 2019 e atës 27.12.2019; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar SH.L e datës 20.06.2022; Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e kriterëve specifike për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit në MPJD; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar SH.L e datës 19.09.2022; Shkresë-Mendim; Vërtetim i marrëdhënies së punës me nr.ref.11.1.289/15 e datës 10.06.2015; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar E.K e datës 09.05.2022; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar L.H, B.B, I.LI; e datës 20.05.2022; Njoftim për Komisionin e Ristrukturimit; Vërtetim i lësuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut me nr.123/05 e datës 16.05.2005; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar SH.L e datës 20.06.2022; Email i dërguar nga E.K drejtuar B.I e datës 28.06.2022; E-mail i dërguar nga E.K drejtuar D.G e datës 21.09.2022; Email i dërguar nga E.K dërguar nga SH.L e datës 19.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi Ejup Kamberaj sipas Akt Emërimit me Nr.219/2014 të datës 10.03.2014 ka qenë i emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në ish Ministrinë e Diasporës, cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo që për këtë pozitë janë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht kualifikimet e posaçme formale ku është paraparë *Njohje e gjuhës angleze në nivelin B1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze, dhe rrjedhimisht ankuesi ka hyr në procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit ku i njëjti sipas raportit me numër protokolli 596 të datës 19.04.2022 të Komisionit të Ristrukturimit, nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale sipas kërkesave të përcaktuara ligjore për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit.*

Ankuesi me datë 10.08.2022 parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkurseve për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve në MPJD dhe me datë 22.08.2022 kundër heshtjes administrative për mos sistemim në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli gjatë vendosjes së ankesës së ankuesit të datës 22.08.2022 ka pranuar si provë shtesë



edhe Vendimin me numër Nr.139/2022 dhe numër protokoli 1373 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë lidhur me sistemimin e ankuesit në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut” në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke e obliguar Komisionin e Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankuesit.

Andaj nisur nga gjendja faktike si me lartë, dhe duke qenë se objekti i ankesës A.nr.907/2022 i datës 13.10.2022 i referohet vendimit i cili është shfuqizuar nga Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave vlerëson se objekti i ankesës respektivisht qëllimi i ankesës se ankuesit me numër A.nr.907/2022 të datës 13.10.2022 është bërë i pamundur - kotë, kështu që në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative cili përcakton se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”, Kolegji vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës së ankueses me numër A.nr.907/2022 të datës 13.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.907/2022**

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.